


### Fleta e punës për nxënësit 4.4

#### Cila është balanca optimale midis riprodhimit të peshkut dhe sasisë së kapur?

Rezervat e peshkut prodhojnë sasi më të mëdha ose më të vogla të peshkut të ri, në varësi nga sasia e peshkut të mbetur në liqen pas mbarimit të sezonit të peshkimit. Cila është sasia e peshkut që jep sasinë më të madhe të peshkut të ri? Përgjigja për këtë pyetje jep çelësin për një peshkim të qëndrueshëm.

Rinovimi i sasisë së peshkut në ton



Rinovimi

Rezervat e peshkut në fund të sezonit në ton

Stok në fund të sezonit	Rinovimi (prodhimi i peshkut të ri)	Sasia stok në fillim të sezonit të ri
80	29	109
85	31	116
90	34	124
95	39	134
96	40	136
97	41	138
98	42	140
99	42	141
100	42	142
101	41	142
102	40	142
103	40	143
104	39	143
105	39	144
110	36	146
115	32	147
120	28	148

Kjo tabelë tregon **normat e pikut të rinovimit** që rezervat e peshkut janë të afta për të prodhuar. Këto norma janë ideale për peshkim të qëndrueshëm.